

## **Kombet e Bashkuara**

### **Asambleja e Përgjithshme 12 tetor 2011**

**Këshilli i të Drejtave të Njeriut**  
**Seanca e tetëmbëdhjetë**  
Pika 3 e Axhendës

**Promovimi dhe mbrojtja e të gjitha të drejtave të njeriut, të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, duke përfshirë edhe të drejtën për zhvillim**

**Rezolutë e miratuar nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut**

**18/1**

**E drejta e njeriut për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime**

*Këshilli i të Drejtave të Njeriut,*

*Duke riafirmuar të gjitha rezolutat e mëparshme të Këshillit për të Drejtat e Njeriut dhe aksesin në ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime, në veçanti rezolutën 7/22, datë 28 mars 2008 dhe rezolutën 12/8, datë 1 tetor 2009, 15/9, datë 30 shtator 2010, dhe 16/2, datë 24 mars 2011,*

*Duke kujtuar rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 64/292, datë 28 korrik 2010, në të cilën Asambleja njohu të drejtën për ujë të pijshëm të pastër dhe të sigurt dhe për kanalizime si një të drejtë të njeriut, e cila është thelbësore për gëzimin e plotë të jetës dhe të të gjitha të drejtave të njeriut;*

*Duke kujtuar gjithashtu mbajtjen e takimit plenar të Asamblesë së Përgjithshme datë 27 korrik 2011 me titull “E drejta e njeriut për ujë dhe kanalizime”,*

*Duke kujtuar më tej Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventën për të gjitha Format e Eliminimit të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,*

*Duke kujtuar gjithashtu dispozitat përkatëse të deklaratave dhe programeve që lidhen me aksesin në ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime miratuar nga shumica e konferencave dhe samiteve të Kombeve të Bashkuara dhe nga Asambleja e Përgjithshme në sesionet e saj të veçanta dhe gjatë takimeve pasuese, midis të tjerave, nga Plani i*

**Burimi: Enti Rregullator i Ujit**  
**Përkthimi i këtij materiali nuk është zyrtar.**

Veprimet Mar del Plata për Ujin dhe Zhvillimin dhe Administrimin, miratuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbajtur në mars të vitit 1977, Axhenda 21 dhe Deklarata e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin, miratuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin mbajtur në qershor të vitit 1992, dhe Axhenda e Habitatit, miratuar në Konferencën e dytë të Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet e Njeriut mbajtur në vitin 1996, rezolutat e Asamblesë 54/175, datë 17 dhjetor 1999 për të drejtën për zhvillim, dhe 58/271, datë 23 dhjetor 2003 që shpalli Dhjetëvjeçarin Ndërkombëtar për Veprim, “Ujë për Jetën” (2005-2015),

*Duke parë me interes angazhimet dhe nismat rajonale që promovojnë një realizim të mëtejshëm të detyrimeve të të drejtave të njeriut që lidhen me aksesin në ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime, duke përfshirë edhe Protokollin për Ujë dhe Shëndet, miratuar nga Komisioni Ekonomik për Evropën në vitin 1999, Kartën Evropiane për Burimet Ujore, miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 2001, Deklarata e Abujës, miratuar në samitin e parë të Afrikës dhe Amerikës së Jugut në vitin 2006, mesazhi nga Bepu, miratuar në samitin e parë Aziatiko-Paqësor të Ujit në vitin 2007, Deklarata e Delhit, miratuar në Konferencën e tretë Aziatiko-Jugore për Kanalizimet në vitin 2008, dhe Dokumenti Përfundimtar i Sharm el Sheikut, miratuar në Konferencën e Samitit të pesëmbëdhjetë të Krerëve të Shteteve dhe Qeverive të Lëvizjes së Vendeve të Paradhitura në vitin 2009, dhe Deklaratën e Kolombos, miratuar në Konferencën e katërt Aziatiko Jugore për Kanalizimet në vitin 2011,*

*Duke pasur parasysh angazhimet e ndërmarra nga komuniteti ndërkombëtar për të arritur plotësisht Qëllimet për Zhvillim të Mijëvjeçarit dhe duke theksuar në këtë kontekst vendosmërinë e Krerëve të Shteteve dhe Qeverive, siç shprehet në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për Mijëvjeçarit për të përgjysmuar deri në vitin 2015 numrin e njerëzve që nuk kanë mundësi të kenë apo të përballojnë kostot e ujit të pijshëm të sigurt, dhe për të përgjysmuar numrin e njerëzve që nuk kanë akses në kanalizime bazë, siç është rënë dakord në Planin e Zbatimit të Samitit Botëror për Zhvillim të Qëndrueshëm (“Plani i Zbatimit të Johaneshburgut”) dhe dokumentin e miratuar në Takimin Plenar të nivelit të lartë të sesionit 65 të Asamblesë së Përgjithshme të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit me titull “Mbajtja e premtimit: të bashkuar për të arritur Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit”,*

*Duke kujtuar rezolutën 64/24 të muajit maj 2011, në të cilën Asambleja u bëri thirrje Shteteve Anëtare që, midis të tjerash, “të garantojnë që strategjitë kombëtare të shëndetit të kontribuojnë në realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit që lidhen me ujin dhe kanalizimet ndërkohë që mbështesin realizimin progresiv të të drejtës së njeriut për ujë dhe kanalizime që i japin të drejtë kujtudo, pa diskriminim, për të pasur ujë dhe kanalizime që janë të mjaftueshme, të sigurta, të pranueshme, fizikisht të aksesueshme dhe të përballueshme për përdorim personal dhe familjar”*

*Të shqetësuar thellësisht për faktin se rreth 884 milionë njerëz nuk kanë akses në burime të përmirësuara ujore siç përcaktohet nga Organizata Botërore e Shëndetit dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët në raportin e tyre të Programit të Përbashkët të Monitorimit, dhe se më shumë se 2.6 miliardë njerëz nuk kanë akses në kanalizime*

bazë, si dhe të alarmuar se rreth 1.5 milionë fëmijë nën moshën 5 vjeç vdesin dhe se 443 milionë ditë shkolle humbasin çdo vit si rezultat i sëmundjeve të lidhura me ujin dhe kanalizimet,

*Duke konfirmuar* nevojën për t'u fokusuar tek perspektiva lokale dhe kombëtare në trajtimin e kësaj çështjeje, duke lënë mënjanë çështjet e së drejtës ndërkombëtare të ujit dhe gjithë çështjet e ujërave ndërkufitare,

1. *Mirëpret* njohjen e së drejtës së njeriut për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime nga Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i të Drejtave të Njeriut dhe konfirmimin nga kjo e fundit se e drejta e njeriut për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime rrjedh nga e drejta për një standard të mjaftueshëm jetese dhe është e lidhur pazgjidhshmërisht me të drejtën për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor, si dhe me të drejtën për jetën dhe për dinjtëtin njerëzor;
2. *Mirëpret gjithashtu* punën e Raportueses së Posaçme për të drejtën për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime, duke përfshirë progresin në mbledhjen e praktikave të mira, konsultimet e plota, transparente dhe gjithëpërfshirëse që bëhen me aktorët përkatës dhe të interesuar nga të gjitha rajonet për raportet e saj tematike, si dhe për ndërmarrjen e misioneve në vende të caktuara;
3. *Pranon me vlerësim* raportin e tretë vjetor të Reporteres së Posaçme<sup>1</sup> dhe merr parasysh me interes rekomandimet dhe sqarimet e saj në lidhje me planifikimin lokal dhe kombëtar të zbatimit të së drejtës për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime;
4. *Mirëpret* dorëzimin e përmbledhjes së praktikave të mira për të drejtën për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime<sup>2</sup>, në të cilën Reporterja e Posaçme thekson në mënyrë të veçantë zgjidhjet praktike sa i përket zbatimit të së drejtës së njeriut për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime.
5. *Rikonfirmon* se Shtetet kanë përgjegjësinë kryesore për garantimin e realizimit të plotë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe se duhet të marrin hapa, në nivel kombëtar dhe përmes asistencës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, sidomos asaj ekonomike dhe teknike, në maksimumin e burimeve të saj të disponueshme, për arritjen në mënyrë progresive të realizimit të plotë të së drejtës së njeriut për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime nëpërmjet gjithë mjeteve të përshtatshme, duke përfshirë edhe miratimin e masave legjislative në zbatimin e detyrimeve të tyre për të drejtat e njeriut;
6. *Rikonfirmon gjithashtu* rolin e rëndësishëm që planet kombëtare të veprimit mund të luajnë si mjete për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç theksohet në Deklaratën dhe Programin e Veprimit të Vjenës, miratuar nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut, datë 25 qershor 1993, duke përfshirë edhe promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës së njeriut për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime.
7. *I bën thirrje* Shteteve:

---

<sup>1</sup> A/HRC/18/33.

<sup>2</sup> A/HRC/18/33/Add.1.

- (a) Të monitorojnë vazhdimisht dhe të analizojnë rregullisht statusin e realizimit të së drejtës për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime mbi bazën e kriterëve të disponueshmërisë, cilësisë, pranueshmërisë, aksesueshmërisë, dhe përballueshmërisë financiare;
- (b) Të vlerësojnë politikat, programet dhe aktivitetet ekzistuese në sektorët e ujësjellës kanalizimeve, duke i dhënë vëmendjen e duhur menaxhimit të ujërave të zeza, duke përfshirë trajtimin dhe ripërdorimin, dhe për të monitoruar burimet e alokuara për rritjen e aksesit të mjaftueshëm, si dhe për të identifikuar aktorët dhe kapacitetet e tyre;
- (c) Të zhvillojnë plane dhe strategji të plota, duke përfshirë përkufizimin e përgjegjësive për të gjitha aktorët e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, për të arritur progresivisht realizimin e plotë të së drejtës për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime për të gjithë, pse për t'i riekzaminuar dhe rishikuar ato aty ku është e nevojshme për të garantuar përputhshmërinë e tyre me standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut;
- (d) Të vlerësojnë nëse kuadri ekzistues i politikave dhe ai legjislativ është në përputhje me të drejtën për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime, dhe për ta shfuqizuar, ndryshuar, apo përshtatur atë me qëllim që të përmbushë standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut;
- (e) Të sigurojnë transparencë të plotë të procesit të planifikimit dhe zbatimit në ofrimin e ujit të pijshëm të sigurt dhe kanalizimeve, si dhe një pjesëmarrje aktive, të lirë dhe kuptimplotë të të gjitha komuniteteve lokale të interesuara dhe aktorëve përkatës, sidomos të njerëzve që jetojnë në situata të disavantazuara, të marxhinalizuara dhe vulnerabël;
- (f) Të përcaktojnë standarde për aksesin që duhen arritur në periudha të shkurtra kohore për ofrimin universal të shërbimeve, duke u dhënë përparësi realizimit të një niveli bazë shërbimi për çdo njeri, para përmirësimit të nivelit të shërbimit për ata që e marrin tashmë këtë shërbim;
- (g) Të përcaktojnë tregues, duke përfshirë të dhëna të plota, bazuar tek kriteret e të drejtave të njeriut, për të monitoruar progresin dhe për të identifikuar mangësitë që duhen korrigjuar dhe sfidat që duhen kapërcyer;
- (h) Të sigurojnë financimin maksimal të burimeve të disponueshme me qëllim që të zbatojnë të gjitha masat e nevojshme për garantimin e qëndrueshmërisë së sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve dhe përballimin financiar të shërbimeve nga të gjithë, duke garantuar ndërkohë që burimet e alokuara nuk kufizohen tek infrastruktura, por përfshijnë edhe burime për aktivitete rregullatore, funksionim dhe mirëmbajtje, si dhe për strukturën institucionale dhe drejtuese dhe masat strukturore, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve;
- (i) Të parashikojnë një kuadër rregullator që synon garantimin e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga të gjithë ofruesit e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve dhe mosshkeljen prej tyre të kriterëve të të drejtave të njeriut, gjatë decentralizimit të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve me qëllim që të sigurojë përputhshmëri me të drejtat e njeriut dhe zbatimin e të njëjtave standarde në gjithë vendin;

- (j) Të parashikojnë një kuadër përgjegjshmërie, që ofron mekanizma të mjaftueshëm monitorimi dhe zgjidhje ligjore, duke përfshirë masa për kapërcimin e pengesave në aksesin në drejtësi dhe mekanizma të tjerë përgjegjshmërie, dhe të pengesave që lidhen me mosnjohjen e ligjit, të drejtave të njeriut dhe mundësive për t'i kërkuar këto të drejta;
8. *I fton* Shtetet të vazhdojnë të promovojnë, në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe nivelet më të larta, realizimin e plotë të së drejtës së njeriut për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime në nismat e ardhshme kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, midis të tjerash, Forumin Global për Kanalizime dhe Higjienë të Këshillit Bashkëpunues të Ujësjetës-Kanalizimeve në tetor 2011 në Mumbai, Indi, dhe Forumin e gjashtë Botëror të Ujit në mars 2012 në Marsejë, Francë;
  9. *Thekson* rolin e rëndësishëm të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe asistencës teknike të ofruar nga Shtetet, agjencitë e specializuara të sistemit të Kombeve të Bashkuara, partnerëve ndërkombëtare dhe atyre për zhvillim, si dhe agjencive donatore, ne veçanti arritjes në kohën e duhur të Objektivave përkatës të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, dhe u bën thirrje partnerëve për zhvillim që të miratojnë një qasje të orientuar nga të drejtat e njeriut në hartimin dhe zbatimin e programeve për zhvillim në mbështetje të nismave dhe planeve kombëtare të veprimit në lidhje me gëzimin e aksesit në ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime;
  10. *I inkurajon* të gjitha qeveritë të vazhdojnë t'i përgjigjen në mënyrë të favorshme kërkesave të Reporterit të Posaçme për vizita dhe informacione dhe të zbatojnë me efikasitet rekomandimet e mbajtësit të mandatit dhe të vënë në dispozicion informacionet lidhur me masat e marra në këtë drejtim;
  11. *I kërkon* Reporterit të Posaçme të vazhdojë të raportojë çdo vit para Këshillit dhe të paraqesë një raport vjetor në Asamblenë e Përgjithshme;
  12. *Inkurajon* Reporterin e Posaçme që të lehtësojë, duke përfshirë edhe përmes angazhimit të aktorëve të interesuar, sigurimin e asistencës teknike në fushën e së drejtës së njeriut për ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime;
  13. *I kërkon* Sekretarit të Përgjithshëm dhe Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për t'i ofruar Reporterit të Posaçme të gjitha burimet dhe asistencën e nevojshme për përmbushjen efikase të mandatit të saj;
  14. *Vendos* të vazhdojë të konsiderojë këtë çështje në të njëjtën pikë të axhendës dhe në përputhje me programin e tij të punës.